



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHPËRBLIM TË ARSYESHËM NGA
RIPRODHIMI I VEPRAVE PËR PËRDORIM PRIVAT OSE PËR PËRDORIM
TJETËR PERSONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. PËRKUFIZIME

Përkufizimet e përdorura në ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa përkufizimet shitesë, në kuptimin e këtij vendimi, janë:

“Tarifa për shpërblim të arsyeshëm” tarifa që paguhet nga prodhuesit vendas në rastin e shitjes së parë dhe/ose importuesit e pajisjeve/aparateve/makinerive/materialeve në territorin e Republikës të Shqipërisë, kundrejt Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.UADA, për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, bazuar në një kontratë/marrëveshje mes tyre.

“Prodhuesi vendas dhe importuesi” çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon ose importon në Republikën e Shqipërisë pajisjet/aparatet, suportet/njësitë ose mjete të tjera të reja për regjistrimin vizual dhe zanor.

II. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton tarifat për shpërblim të arsyeshëm nga shitja e parë ose importi i pajisjeve/aparateve/makinerive/materialeve/njësive në Republikën e Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 31 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të

drejtat e tjera të lidhura me to”, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal.

2. Ky shpërblim do të paguhet në emër dhe për llogari të Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (S.U.A.D.A.), nga të gjithë prodhuesit vendas në rastin e shitjes së parë dhe/ose importuesit e këtyre pajisjeve/aparateve/makinerive/materialeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. DETYRIMI PËR SHPËRBLIMIN NGA PAJISJET/APARATET DHE SUPORTET/NJËSITË OSE NËPËRMJET MJETEVE TË TJERA TË REJA PËR REGJISTRIMIN VIZUAL DHE ZANOR

1. Lista e pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësive ose nëpërmjet mjeteve të tjera, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet regjistrimit vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimit/regjistrimin e tekstit, është përcaktuar në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Prodhuesi vendas në rastin e shitjes së parë dhe importuesi janë të detyruar të paguajnë tarifën për shpërblim të arsyeshëm kundrejt Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (SUADA), sipas Shtojcës nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi. Mënyra e shpërndarjes së të ardhurave bëhet nga Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (SUADA), në përputhje me nenin 139, të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.
3. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/aparateve, si dhe për suportet/njësitë është 0.5 % (përqind).
4. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm llogariten sipas vlerës në % (përqindje), sipas rastit, të:
 - a) vlerës doganore të pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësive riprodhuese që bëjnë të mundur regjistrimin vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimit/regjistrimin e tekstit, në analog, digjital dhe të importuara.
 - b) faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, të pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësive riprodhuese që bëjnë të mundur regjistrimin vizual dhe/ose zanor si dhe fiksimit/regjistrimin e tekstit, në analog dhe digjital, pa TVSH, të prodhuar në Republikën e Shqipërisë.
5. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm për përdorim privat ose përdorim tjetër personal paguhet çdo muaj, deri në 30 ditë nga muaji pasardhës në numrat e llogarisë së Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.U.A.D.A. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organi kompetent tatimor për prodhuesin e pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njësive riprodhuese vendosin në dispozicion të Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.U.A.D.A., informacionin e nevojshëm për përlllogaritjen e këtyre tarifave. Ky informacion përfshin:

- a) Numri i deklarave doganore (import), data e deklaratës doganore, vlera doganore (vlera statistikore), NUIS i subjektit importues;
 - b) në numrin e faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit vendas, pa TVSH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë, numrin e këtyre faturave dhe numrin NUIS të subjekteve prodhuese.
6. Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.U.A.D.A dhe importuesit ose prodhuesit vendas, sipas rastit, llogarisin tarifat për shpërblim të arsyeshëm që do të paguhet nga importuesi/prodhuesi vendas në bazë të kontratës/marrëveshjes përkatëse me Sportelin Unik.
 7. Shkëmbimi i të dhënave të përcaktuara në pikën 5 të kreut III të këtij vendimi, kryhet bazuar në një marrëveshje të lidhur ndërmjet organeve kompetente doganore dhe tatimore dhe ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit.
 8. Për përfundimin e kontratës/marrëveshjes mes Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.U.A.D.A dhe importuesit dhe/ose prodhuesit vendas, këta të fundit duhet të vendosin në dispozicion informacionin në lidhje me:
 - a) listën e pajisjeve/aparateve dhe suporteve/njërive që prodhohen apo importohen në Republikën e Shqipërisë;
 - b) llogaritjen e bazuar për çdo pajisje/aparat dhe suport/njësi sipas Shtojcës Nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky informacion nuk bëhet publik dhe ruan konfidencialitetin.
 9. Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (SUADA), përcakton mënyrën e shpërndarjes së shpërblimeve dhe llogaritjen e kostove, sipas nenit 139 dhe 151, të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

IV. DETYRIMI PËR SHPËRBLIMIN NGA PAJISJET/MAKINERITË /MATERIALET E REJA TË FOTOKOPJIMIT

1. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm për përdorim privat ose përdorim tjetër personal, në përputhje me germën “c”, të pikës 5 të nenit 31, të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, janë të detyrueshme të paguheshin me rastin e shitjes së parë, nga prodhuesit në Republikën e Shqipërisë ose nga importuesit e çdo pajisjeve/makinerie të reja të fotokopjimit tek Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit (SUADA).
2. Lista e pajisjeve/makinerive të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet fotokopjimit në letër ose në çdo teknikë tjetër riprodhimi që njehsohet dhe ka të njëjtin efekt me fotokopjimin, është përcaktuar në Shtojcën Nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm për listën e pajisjeve/makinerive është 0.5 % (përqind).
4. Vlera në % (përqindje) e parashikuar në pikën 3, të kreut IV, të këtij vendimi llogaritet, sipas rastit, nëpërmjet:
 - a) Vlerës doganore për çdo pajisje/makineri të importuar;
 - b) Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, pa TVSH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë.
5. Pikat 5, 6, 7, 8, 9 të kreut III, të këtij vendimi zbatohen në të njëjtën mënyrë edhe për prodhuesit dhe importuesit e pajisjeve/makinerive, të cilat bëjnë të mundur riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat dhe vetjak ose për përdorim tjetër personal nëpërmjet fotokopjimit në letër ose në çdo teknikë tjetër riprodhimi që njehsohet dhe ka të njëjtin efekt me fotokopjimin.

V. SHPËRBLIMI PËR PRODUKTET ZËVENDËSUESE OSE PJESË TË PAJISJEVE/MATERIALEVE/APARATEVE TË TJERA

1. Tarifat për shpërblim të arsyeshëm të përcaktuara në Kreun III dhe IV të këtij vendimi, paguhen për çdo pajisje/aparat/makineri/material, pavarësisht nëse ajo mund të importohet ose të shitet si një produkt zëvendësues ose si pjesë e një pajisje/aparati/makinerie/materiali tjetër.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Sporteli Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit, S.U.A.D.A për zbatimin e këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për përcaktimin e kodeve tarifore të mallrave të listuara në Shtojcën 1 dhe 2.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Shtojca Nr.1

Shpërblimi në % (përqindje)	Suporte/Njësi	Mënyra e llogaritjes	
		Për importuesit nëpërmjet:	Prodhuësit vendas nëpërmjet:
0.5%	Suporte/Njësi: 1.Kartë Memorie (përveç atyre të aparateve celulare); 2.Disc/Bluray; 3.HDD,DVD; 4.Kaseta,Audio; 5.Minidisk; 6. Video regjistruar i llojit VHS, Super VHS (përveç regjistruarve për kamera portative si: Video 8, Digital 8 Hi8, DVM, VHS-C, Super VHS-C), D-VHS, HD video kasetë; 7. Çdo lloj i DVD ose CD boshe. 8. Karta e memories 9. Televizor dhe çdo aparat me hardisk të brendshëm si edhe video dixhitale me memorie të brendshme, ku bëhet i mundur regjistrimi audio / video, MP3 player, MP4 player, iPod media player që mbështet formate: AVI, MPEG-1, MPEG-2, MPEG-4, XVID, DIVX (v3.11, v4.x, V.5x, V.6x), XVID / VCD, SVCD, DVD, ACC, ĖMA, ĖMV, ASF, MP3, MP4, ĖAV, IMOD dhe çdo version tjetër të ngjashëm me to për të gjitha rastet e zhvillimeve teknologjike të mëvonshme. 10. Bluray regjistruar;	Vlerës doganore	Faturave mujore të lëshuara nga prodhuësit, pa T.V.SH, për çdo pajisje/machine ri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë

0.5 %	11. HD DVD regjistruet; 12. Audio regjistruet; 13. Minidisk regjistruet; 14. Video regjistruet; 15. CD regjistruet, pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur; 16. DVD regjistruet pajisjet HI-FI që funksionojnë në mënyrë të pavarur; 17. MP3 regjistruet; 18. CD regjistruet; 19. DVD regjistruet; 20. Kompjuterat me lexues CD; <i>(përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit me të cilin tregton CD ëriter)</i> 21. Kompjuter me lexues DVD; <i>(përqindja vlen edhe për shumën që përfaqëson 7% të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me DVD regjistruet)</i> 22. Hard Disk i jashtëm; 23. Hard Disk i brendshëm; <i>(Përqindja aplikuar për një shumë që përfaqëson 10% të të gjithë sistemit që është shitur së bashku me hard drive);</i> 24. Kartë memorie e lëvizshme; 25. Telefona që riprodhojnë zë apo audio regjistrime vizuale MP3, MP4, AAC, ĒMA, ĒAV, etj. (për shembull iPhone, etj) me një kapacitet ruajtje më të madh se 4 Gb.		
-------	---	--	--

Shtojca Nr.2

Shpërblimi në % (përqindje)	Pajisje/Makineri Material riprodhues	Mënyra e llogaritjes	
		Për importuesit nëpërmjet:	Prodhesit vendas nëpërmjet:
0.5 %	Pajisje/Makineri: 1. Fotokopjet; 2. Printerat; 3. Skanerat; 4. Pajisjet/makineritë multifunksionale të tjera të ngjashme me/pa funksion fotokopjues.	Vlerës doganore	Faturave mujore të lëshuara nga prodhuesit, pa T.V.SH, për çdo pajisje/makineri të prodhuar në Republikën e Shqipërisë